BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE *(BulletinonNaturalHazards)*
Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore
Facebook page: InstitutiiGjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 294/ 2026, 21-10-2026	**Parashikimi** nga 21-10-2026, ora 12:00 deri 22-10-2026, ora 23:59.

PARASHIKIMI METEO

RESHJET

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 21) dhe nesër (e enjte, dt. 22) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë dhe reshje mesatare në qarqet Dibër, Durrës dhe Tiranë të shoqëruara me shtrëngata. Në qarqet Elbasan, Fier dhe Gjirokastër priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).
Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si rrëshqitje të dherave dhe vërshime të ujit në zonat urbane të lokalizuara, në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Durrës dhe Vlorë.

TEMPERATURA

Nesër (e enjte, dt. 22) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 15 / 22 °C
në vendet e ulëta: 13 / 23 °C
në vendet malore: 7 / 19 °C

ERA

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 21) dhe nesër (e enjte, dt. 22) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet për momente deri e fortë.

ZJARRET NË PYJE

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 21) dhe nesër (e enjte, dt. 22) pritet nivel "S'KA RREZIK" në të gjithë qarqet (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

NIVELET E RREZIKUT	**S'KA RREZIK**	**I ULËT**	**I MODERUAR**	**I LARTË**

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	*Zjarre nëpyje*	*Ngjarje Meteorologjike*			*Ngjarje Hidrologjike*		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	*Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*	*Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*	*Shtrëngata*	*Përmbytje të Shpejta*	*Përmbytje Lumenjsh*	*Rrëshqitje toke*
SHKODËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare					
LEZHË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare					
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare					
ELBASAN	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
FIER	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
BERAT	S'KA RREZIK	të dobëta					
KORÇË	S'KA RREZIK	të dobëta					
VLORË	S'KA RREZIK	mesatare					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				

Buletini Nr. 294 / 2026, 21-10-2026	**Parashikimi** nga 21-10-2026, ora 12:00 deri 22-10-2026, ora 23:59.

LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

NiveliiRrezikut	***Reshjeshiu*** (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90mm / 24 orë) Moti është shumëirrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrëngata: reshje mbi 20mm/3orë. Moti mund të krijojë problem të ndryshme.
	Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël.
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj.
	Rrëshqitje toke.



RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 21 – 22.